



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËVAJTJE NË PRIZREN/ OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U**  
**PRIZRENU/ MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN PRIZREN**

Nr. 494/2012-04

**GJYKATA KOMUNALE PER KUNDËVAJTJE NE PRIZREN**, me gjykatesin Fatmir Krasniqin dhe sekretaren juridike Fatime Bajraktarin ne proceduren kundervajttese kunder te pandehurit Afrim Avdaj nga Prizreni, per shkak te kundervajtjes nga neni 17 p.1.3 te Ligjit per deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurise dhe te zyrtareve te larte publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave per te gjithë personave zyrtare, e ne baze te nenit 195 te LMK, me dt. **24.12.2012** morri kete,

**A K T V E N D I M**

**PEZULLOHET**, procedura kundervajttese kunder te pandehurit Afrim Qemal Avdaj nga Prizreni rr. Sylejman Rrotlla nr. 16, per shkak te kundervajtjes nga neni 17 p.1.3 te Ligjit te lartecekur,

- ne baze te nenit 198 al.1 p.8 te LMK, sepse nuk ka prova se ka kryer kundervajtje,

**A r s y e t i m**

Sipas kerkeses se Agjencionit kunder korupsionit ne Prishtine me nr. 01-1909/2012 te dt. 24.05.2012 per Zhvillimin e procedures kundervajttese kunder te pandehurit Afrim Avdaj nga Prizreni, per shkak te kundervajtjes nga neni 17 p.1.3 te Ligjit te lartecekur.

Gjendja faktike eshte e vertetuar permes deklarates se te pandehurit, deshmitarit dhe me administrimin e provave tjera ne shkresat e lendes.

I pandehuri ne seancen gjyqesore te mbajtur me dt. 06.07.2012 ne mbrojtjen e tij deklaroi, se edhe pse ne detyren e mjekut e ushtron edhe funksionin e zyrtarit te larte publik ngase eshte kuvendar i ansamblese komunale ne Prizren, dhe ne afat te caktuar kohor e ka deklaruar dhe lajmeruar pasurine ndaj agjencionit antikorupsion ne Prishtine, dhe kete e deshmon me origjinalin te vertetimit ndaj agjencionit antikorupsion te dt. 28.03.2012 mbi deklarimin e gjendjes se pasurise se tije, edhe pse afati kohor perfundimtar ka qene i dt. 31.03.2012. Gjykata per ta vertetuar gjendjen e drejte e te plote faktike ne cilesin e personit zyrtar komunal – kordinator i sherbimit profesional KK Prizren – Ibrahim Krasniqi thote se Kuvendari Afrim Avdaj ne afat kohor e ka bere deklarimin e pasurise ndaj agjencionit antikorupsion kete e deshmoj si zyrtar komunal permes listes se anetareve te Kuvendit qe i kane dorezuar deklaratat per vitin 2012, ne mesin e tyre eshte me rradhe i katerti i pandehuri Afrim Avdaj, andaj nga ana e agjencionit antikorupsion ndoshta eshte bere ndonje leshim teknik, per çka gjykata duke e pasur parasysh vertetimin mbi deklarimin e pasurise te agjencionit antikorupsion ndaj te pandehurit Afrim Avdaj ku edhe beri shiqimin e vertetimit dhe kontatoi se ne afat te caktuar ligjore i pandehuri e ka deklaruar gjendjen e pasurise ndaj agjencionit antikorupsion e ne kuptim te nenit 198 al.1 p.8 te LMK, gjykata e pezulloi proceduren kundervajttese sepse nuk ka prova se i pandehuri ka kryer kundervajtje.

DPK/DMP  
02


03-227/2013  
01.03.2013

Me sa u cek me larte, u vendos si ne dispozitiv te aktvendimit.

03-227/2013/02  
sluz

**GJYKATA KOMUNALE PER KUNDERVAJTJE NE PRIZREN**  
Nr. 494/2012 te dt. 24.12.2012

**Sekretare Juridike**  
Fatime Bajraktari



**Gjykatesi**  
Fatmir Krasniqi

**UDHEZIMI JURIDIK** : Kunder ketij aktvendimi, mund te kerkohet ankese, ne afat prej 8 diteve, nga dita e pranimit te te njejtit, Gjykates se Larte per Kundervajtje ne Prizren, nepermjet te kesaj gjykate pa taksa.